

# RELACION TEKNIK

## ARKITEKTURA

### OBJEKTI: HARTIM PROJEKTI PERNDERTIMIN E PALESTRES SE SHKOLLES 9 VJECARE “SEVASTI QIRIAZI” KORCE

#### HYRJE



Shkolla 9 vjecare “Sevasti Qiriazhi” ndodhet ne Bashkine Korce, ne Zonen Kadastrale nr.8562, pasuria 2/413/1+2/413/2, ne rrugen “ Foqon Postoli”.

Shkolla perbehet nga dy godina 2 dhe 3 kateshe te ndertuara ne forme L ku behet mesim nga klasa e pare deri ne klasen e nente.

Ne oborrin e shkolles do te ndertohet palestra me siperfaqe afersisht 210 m2, për të akomoduar aktivitetet sportive të nxënësve të shkollës në kushte sa me bashkekohore.

Referuar kerkesave ne detyren e projektimit, zgjidhja e bere ne projektin Arkitektonik, i ploteson kushtet e kerkuara per nje ambjent sportiv, i cili do te frekuentohet dhe nga komuniteti perreth shkolles.





Pamje te gjendjes aktuale te shkolles dhe oborrit te saj.

## PAMJE 3D E OBJEKTIT QE DO NDERTOHET



# ARKITEKTURA

## PËRSHKRIMI I OBJEKTIT

Objekti i palestres vendoset në një sipërfaqe trualli prej 1910 m<sup>2</sup>, me numer pasurie 2/413/1+2/413/2, ne te cilin jane ndertuar 2 godinat e shkolles 9 vjecare “Sevasti Qiriaz” Ky objekt ka një sipërfaqe të njollës prej 209 m<sup>2</sup> dhe ngrihet në lartësinë 7.5 m. Sheshi i ndertimit eshte i sistemuar dhe nuk ka nevojë për nivelim të terrenit. Funkcioni i objektit që do të ndertohet eshte për palester mesimore e cila do të frekuentohet dhe nga komuniteti përreth brenda mundesive.

Objekti eshte projektuar të ndertohet me konstrukcion metalik (kollonat dhe catia), ndersa mbulimi dhe muret anesore do të jene me panele sanduich.

Ne pjesen e brendeshme muret prej sanduich-i nuk do të vishen me material tjetër, po ashtu dhe tavan të varur nuk do të ketë. Do të jete i dukshem paneli sanduich i mbulimit dhe konstrukcioni i kapriates.

Dyshemeja do të jete e shtruar me parket nën të cilin do ketë një shtresë betoni me zgare hekuri, hidroizolim me 2duar mapej dhe një shtresë autonivelant.

Dritaret do të jene d/alumin me xham të armuar me rrjete teli për mbrojtje.

Dyert e brendeshme do të jene prej druri, ndersa dera e jashtme do të jete e blinduar.

Ne anën e murit pa dritare do të vendosen stola prej druri për qëndrimin e nxenesve.

Midis godines së shkolles dhe palestres eshte parashikuar një koridor kalimi 1m i cili do të shërbejë për futjen në palester të nxenesve në orarin e mesimit dhe të komunitetit në kohën e lire. Në këtë hapsirë eshte parashikuar

Fasada e objektit eshte parashikuar të vishet nga jashtë me sistem kapote me suvatim me grafiato për ruajtjen e temperaturave të brendeshme të saj dhe funksion estetik.

**Të dhëna teknike :**


Sip. totale e pronës = 1910 m<sup>2</sup>

Sip. Totale ndertimi = 209 m<sup>2</sup>

Sip. e truallit të zene nga struktura = 209 m<sup>2</sup>

Lartësia totale e objektit = 7.5m Sip. e katit përde dyqane = 481 m<sup>2</sup>

Katet mbi toke = 1kat



**Planvendosja e objektit ne harten kadastrale te ASHK Korce**

Ing.Xhuljeta GJINI

Ark.Anila Deneko

